



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1072/8 Prot.

Tiranë, më 22.05 2026

V E N D I M

Nr. 83 dt. 22.05 2026

“PËR ADMINISTRIMIN E PROCEDURAVE TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK GJATË PERIUdhËS SË PUSHIMEVE VERORE”

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, Vendim Nr. 329, datë 12.4.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të Rregullores së Brendshme të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe neneve 8, 9, 10 të Rregullores së Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA), me qëllim garantimin e zhvillimit të rregullt të procedurave administrative dhe të vlerësimit për fitimin e titujve akademikë gjatë periudhës së pushimeve verore, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.05.2026,

VENDOSI:

1. Gjatë periudhës 1 korrik 2026 – 1 shtator 2026, nuk do të zhvillohen procedura të reja shqyrtimi dhe vlerësimi për aplikimet për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).
2. Aplikimet e depozituara pranë KPPA-së gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi do të administrohen nga Sekretaria Teknike dhe shqyrtimi i tyre do të fillojë pas rifillimit të aktivitetit të rregullt të KPPA-së në muajin shtator 2026.
3. Kandidatët që kanë depozituar dosjen dhe kanë nisur procedurat e promovimit akademik përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vijojnë procedurën sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi deri në përfundimin e saj.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Agron KASA

